

Udhëzues

KËRKESAT PËR EVP APLIKOHEN TEK TË GJITHË ANËTARËT E IKAF

Anëtarët të cilët:

- Ushtrorinë punë lidhur me profesionin e kontabilitetit dhe auditimit (me pagesë ose pa pagesë);
- Ushtrorinë profesion tjetër për përfitime;
- Ushtron profesionin e ushëheqësit në një kompani, ose ushtron ndonjë rol i cili përmban përgjegjësi financiare/ligjore; ose planifikon ushtrorinë aktivitetet e lartpërmendura në të ardhmen

duhet të konsiderojnë numrin dhe llojet e aktiviteteve të EVP-ve të përshtatshme për mbajtur kompetencat në rolin (et) e tyre dhe të ndër marrin veprimet e duhura aty ku është e nevojshme.

KËRKESAT

Si anëtarë ju duhet të kryeni dy aktivitetet e mëposhtme.

1. DEKLARATËN VJETORE

Individët e certifikuar raportojnë EVP-të duke dorëzuar një formular raportimi EVP çdo vit, i cili shërben si një deklaratë e nënshkruar që të gjitha kërkesat e aplikueshme të EVP-ve janë përmbushur. Për secilin certifikim të mbajtur kërkohet një formular i veçantë i raportimit EVP.

Mbështetja e dokumentacionit (p.sh. certifikata e përfundimit të trajnimit) duhet të bashkëngjitet së bashku me formular. Individët mund të dorëzojnë formularët e raportimit të EVP-ve online ose në zyret tona.

Është përgjegjësi e individit të certifikuar për të siguruar se EVP-të raportohen konform rregullave dhe kërkesave të IKAF. Përveç raportimit të përfundimit të EVP-ve të kërkuara, siç është thënë më herët, individët e certifikuar duhet të tregojnë nëse ato janë në përputhje me standardet dhe dëshmojnë për përputhshmërinë e tyre me Kodin e Etikës të IKAF.

Raportimi për vitin aktual duhet të përfundojë deri më 31 Dhjetor të çdo viti. IKAF do të lëshojë një dokument apo certifikatë njohje për secilin individ që ka përmbushur me sukses kërkesat e përshkruara me anë të kësaj poltike.

2. KOMPLETO CDO AKTIVITET TË EVP-SË

Në mënyrë të vazhdueshme, dhe duke përdorur gjykimin tuaj profesional, duhet të plotësoni aktivitetet e mëposhtme.

REFLEKTO

- Reflektoni mbi njohuritë dhe shkathtësitë e kërkuara për rolin(et) tuaj.
- Konsideroni përgjegjësitë tuaja dhe pritjet e vendosura nga ju.
- Identifikoni nevojat tuaja për të mësuar dhe zhvilluar - këto duhet të jenë të rëndësishme për rolin tuaj të ardhshëm të karrierës; ato mund të përfshijnë njohuri teknike, etike, ndërgjegjësimin e biznesit, aftësitë e IT dhe aftësitë 'të buta' të tilla si negociimi, menaxhimin e kohës, aftësitë e udhëheqjes së ekipit.

VEPRO

- Kur është e përshtatshme, ndërmerr veprime (ndjek edukimin e vazhdueshëm profesional duke ndjekur seminarët dhe trajnimet IKAF).

NDIKO

- Vlerësoni efektivitetin e këtyre aktiviteteve (si mësimi ju ka bërë më kompetent dhe efektiv, çfarë mund të bëni tani që nuk mund të bënit më parë) dhe shqyrtoni nëse objektivat e mësimin dhe zhvillimit janë përmbushur.

NUMRI I KËRKUAR I EVP-VE

CFARË LLOJI TË AKTIVITETIT?

Numri i orëve vjetore për EVP që kërkohen ndryshon varësisht nga certifikimi / kualifikimi që individit mban dhe statusit raportues. EVP-të duhet të jenë proporcionale dhe relevante për rolin tuaj

| | Statusi Raportues |
|-----------------------------------|-------------------|
| | Praktikues |
| Kategoritë e Certifikimeve | EVP-të vjetore |
| Auditor i Brendshëm i Certifikuar | 40 |
| Auditor i Jashtëm i Certifikuar | 40 |
| Kontabilist i Certifikuar | 40 |
| Teknik i Kontabilitetit | 30 |
| Nëpunës i Kontabilitetit | 30 |

SIGURIMI I DËSHMIVE

Dokumentacioni mbështetës (siç janë certifikatat e përfundimit të programit të EVP-ve që një individ mund të përdorë për të llogaritur numrin e EVP-ve të fituara) duhet të bashkëngjiten së bashku me formularin vjetor të raportimit të EVP-ve.

Çdo vit IKAF do të kryej një kontroll të të dhënave të raportimit të EVP-ve. Individët që do të auditohen janë të detyruar të sigurojnë dëshmi / dokumentacion të EVP-ve që ata kanë ndjekur.

KONTAKT

T +383 44 118 346 +383 38 220 608

www.ikaf.org

Rr. Bedri Pejani Nr. 1, 10000 Prishtinë - Kosovë